



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Vlorë, më 28.04.2026

PROCES-VERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT: Ndertimi i shkolles 9-vjecare Ismail Qemali per vitin 2026

Tipi i Kontratës, E hapur pune

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **Kodi CPV: 45210000-2**
- Punime ndërtimi

VLERA E FONDIT LIMIT:

Fondi Limit: 298,775,474 (dyqind e nentedhjte e tetemilion e shtateqind e shtatedhjte e pesemije e katerqind e shtatedhjte e kater) Leke pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Pogradec ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenet 76, 82 dhe 83 të LPP dhe Nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Kerkesat e mesiperme jane detyruese dhe i sherbejne Autoritetit Kontraktor per te krijuar bindjen e tij se operatoret ekonomik pjesemarres ushtrojne veprimtarine e tyre konform kerkesave te legjislacionit ne fuqi, permbushin kriteret ligjore per te marre pjese ne procedura prokurimi si dhe kane shlyer te gjitha detyrimet tatimore dhe ato te energjise elektrike sipas percaktimeve te legjislacionit perkates.

Po ashtu, paraqitja e sigurimit te ofertes eshte detyrim ligjor i percaktuar nga legjislacioni ne fuqi mesipercituar, si nje mjet garancie per AK ne rast te tërheqjes së ofertës pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave; refuzimit për nënshkrimin e kontratës së prokurimit apo mosparaqitjes së sigurimit të kontratës, kur oferta është shpallur

fituese, ose mosplotësimi të ndonjë kushti tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentet e tenderit.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Operatori ekonomik ofertues duhet të jete i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (regjistrat tregtarë, sipas nenit 77, pika 1/a dhe 2, të LPP-së) dhe të kete në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në *Nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, Nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”*

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Operatori ekonomik ofertues duhet të jete i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (regjistrat tregtarë, sipas nenit 77, pika 1/a dhe 2, të LPP-së) dhe të kete në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e kontratës.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në Nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe në Nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. ku përcaktohet se: “Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar”

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Lloji i procedurës është “E Hapur – Punë Publike - ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar – Prokurim publik me mjete elektronike”, përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të Nenit 43, pika 2, gërma ”a” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi Përcaktimi i vlerës së kërkuar të xhiros (jo më e vogël se vlera e kontratës) është brenda marzhit të lejuar që mund të kërkohet. Gjithashtu për të stimuluar të gjithë operatorët e rinj që operojnë në treg si dhe për rritur numrin e konkurrentëve në kete procedure është gjykuar që vlera e xhiros së kërkuar të jete minimalisht sa vlera e parashikuar e kontrates.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Nenin 43, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të

deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

2.2.2 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor **për keestet e maturuara te vitit 2026** sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar).

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anetar i grupit duhet të dorëzoj vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është rregjistruar sipas QKB-se).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi Ligjor dhe teknik . Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, në të cilin përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre Kjo kerkese eshte vendosur me qëllim që AK të ketë mundësinë të shohë nëse OE pjesmarrës kanë apo jo detyrime ndaj NJ.Q.V, fakt që tregon fleksibilitetin e tyre financiar.

2.2.3 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore të 3 (tre) viteve të fundit (2023, 2024, 2025) të çertifikuar nga organet tatimore si dhe te shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).

Argumentimi Ligjor dhe teknik : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe Nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në Nenin 29 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore“ ”Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars

të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: *“Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:***
*i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej **50 milionë lekësh;*** ii) *shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej **100 milionë lekësh;*** iii) *ka, mesatarisht, **30 të punësuar gjatë periudhës kontabël**”*

2.3 Kapaciteti teknik:

Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **40%** e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet , të realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

b. Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika1/ a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

a) Për kontrata të realizuara me sektorin publik,operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
- Kontratë Sipërmarrje
- Situacionin përfundimtar;
- Aktin e kolaudimit;
- Çertifikatën e marrjes në dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Shënim: *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontrate Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Akt kolaudimi objekti;
- Fature tatimore perkatëse të deklaruar në organet tatimore.

Në rastin e përvojes së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Shënim: *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

1.1 Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, Operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e Bashkimit të operatorëve ekonomikë si dhe prokurën e posaçme të deklaruar në fazën e tenderimit.

1.2 Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor

Argumentimi Ligjor dhe Teknik : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat..50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose minimalisht sa dyfishi i fondit limit, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar me sukses kontratën objekt prokurimi, sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Në mbështetje të Nenit 88, pika 3 e VKM 285/2021, parashikon se: “Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht”

Në mbështetje të Nenit 88, pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se: “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i

përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve”.

Pra në rastet e BOE, dokumentacioni i kërkuar për të vertetuar përvojën e meparshme si kontrata e bashkëpunimit, disponohen nga çdo OE në rastin kur ka qene pale në Bashkimin e OE. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që ka çdo shoqëri në dosjen e saj në rastin kur ka qene në atë status, e për rrjedhojë nuk është në kundërshtim me asnjë nga dispozitat ligjore të prokurimit publik dhe nuk sjelle asnjë kufizim të pjesëmarrjes së OE në procedurën e prokurimit në fjalë.

2.3.2 Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës.

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturas dhe Energji, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” të ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme në ndërtim :

Kategoria NP-1 Niveli A “Punime germimi në tokë”.

Kategoria NP-2 Niveli D “Ndërtime civile dhe industriale.”

Për punimet speciale të ndërtimit :

- **Kategoria NS-1 Niveli A “Punime për prishjen e ndertimev”**
- **Kategoria NS-2 Niveli A “Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre”**
- **Kategoria NS-3 Niveli A “ Impiante ngritëse dhe transportuese(ashensorë,shkallë lëvizëse, Transportues”**
- **Kategoria NS-4 Niveli B “Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese.”**
- **Kategoria NS-12 Niveli B “Impiante teknologjik termik ... “**
- **Kategoria NS-14 Niveli B “ Impiante të brendshme elektrike,telefonike,radiotelefoni TV”**
- **Kategoria NS-18 Niveli A “ Punime Topogjeodezike.”**

Operatorët ekonomikë duhet të kenë licencat e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë ata duhet të paraqesin licencën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 42 datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat për dhënien e licencave profesionale për zbatimin, klasifikimin dhe disiplinimin e personave juridikë që ushtrojnë veprimtari ndërtimore".

Argumentimi Ligjor dhe Teknik : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Gjithashtu, të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, Ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, Neni 8 përcakton “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e

materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose europiane” si dhe Udhëzimit nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, pika 1.1 ku përcaktohet se: çdo subjekt juridik i licencuar ka të drejtë të ushtrojë veprimtari zbatimi, vetëm në klasat dhe kategoritë e punimeve, që ka përcaktuar në licencë. Kushtet dhe kriteret, që duhet të plotësojë subjekti juridik për të fituar klasa e kategori në zbatimin e punimeve të ndërtimit, përcaktohen në rregulloren për dhënien e licencave profesionale, që miraton Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit.

NP-1 A Punime gjurmimi në tokë

Sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008, punime gjurmimi në tokë konsiderohen gjurmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjurmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

Vendosja e kësaj pike license si kriter lidhet me zbatimin e punimeve të parashikuara të realizohen nëpërmjet kësaj procedure. Dokumentacioni teknik i hartuar nga projektuesi parashikon punime gjurmimi dhe sistemimi të dherave. Të tilla punime përfshihen në zërat e punimeve të gjurmimit te dheut.

Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit.

NP-2 D Ndërtime civile e industriale.

Me punime të tilla, referuar VKM nr.42 të datës 16.01.2008 konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar godina banimi, shkolla, zyra, kazerma ushtrie, teatro, stadiume, godina industriale, godina për parkim, burgje, stacione hekurudhore dhe metroje, godina aeroporti me ndonjë punim special në betonarme të thjeshtë ose të parandëruar, betonim të tavaneve të hollë, membrana, kupola, depozita të varura, sillos dhe ndërtime të larta me strukturë me karakteristika të veçanta e komplekse.

Vendosja si kriter teknik i kësaj license lidhet me tipologjinë e ndërtimeve që parashikohen për realizimin e këtij projekti. Ndërhyrjet objekt kontrate, ne teresi është ndërtim i Shkolles 9-Vjecare "Ismail Qemali", që parashikojnë punime betoni dhe F.V hekur betoni periodik.

Në total vlerat për realizimin e strukturave të nevojshme që lidhen me objektin i përcaktojnë të tilla punime në kategorinë D sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008, të ndryshuar.

NS-1 A Punime për prishjen e ndërtimeve

Me punime të tilla, sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar konsideron çmontimi i impianteve industriale dhe prishja komplet e ndërtesave me pajisje speciale ose me përdorim eksploziv me prerje të strukturave betonarme dhe prishjeve në përgjithësi përfshi edhe grumbullimin e mbeturinave, ndarjen e tyre dhe riciklimin e materialeve.

Vendosja e kësaj pike license si kriter lidhet me zbatimin e punimeve të parashikuara të realizohen nëpërmjet kësaj procedure. Dokumentacioni teknik i hartuar nga projektuesi parashikon punime prishje te suvatimit ekzistues ne mure,prishje mur tulle, cmontim dyer dhe dritare ekzistuese, heqje shtrese me pllaka, prishje shtresa betoni, etj, si rezultat i Ndërtimit te Shkolles 9-Vjecare "Ismail Qemali" Vlore . Të tilla punime përfshihen në zërat e punimeve. Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit.

NS-2 A Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre.

Me punime të tilla, sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar konsideron, montimin, mirëmbajtjen ose ristrukturimin e impianteve hidrosanitare të kuzhinës, lavanterisë së gazit dhe kundër zjarrit, sado që të jetë shkalla e rëndësisë së veprave, e kompletuar me punimet e muraturës plotësuese ose ndihmëse, që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

Për zbatimin e projekteve të impianteve hidrosanitare dhe atyre të mbrojtjes nga zjarri, të parashikuara në projektin e zbatimit është e domosdoshme që OE të zotërojë kapacitetet përkatëse të konfirmuar me pikën përkatëse të licensës së nevojshme për zbatimin e punimeve të tilla, sikurse parashikohet në Udhëzimin nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, pika 1.1 më sipër cituar. Vendosja e këtij kriteri i referohet zgjidhjeve grafike, preventivit, specifikimeve teknike, relacioneve të projektit hidroteknik dhe atij të mbrojtjes nga zjarri, si dhe grafikut të punimeve për zbatimin e projektit total “Ndërtimi i Shkolles 9-Vjecare "Ismail Qemali" Vlore”. Në

projektet respektive parashikohen impiantet hidrosanitare të furnizimit me ujë të tualeteve dhe të gjitha masat për mbrojtjen nga zjarri të objektit. Këtu përfshihen të gjitha punimet për instalimin e këtyre rrjeteve, si dhe pajisjet dhe impiantet për vendosjen e tyre në funksion.

Kategoria A i referohet vlerës së këtyre punimeve në preventivin total dhe përcaktimeve të VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar.

N.S - 3 A Impiante ngritëse dhe transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues).

Sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar, me punime për impiante ngritëse dhe transportuese konsiderohet, montimi, mirëmbajtja ose ristrukturimi i impianteve transportuese, ashensorë, shkallë të lëvizshme, ngritëse dhe të transportit, komplet dhe të lidhur me çdo punim murature plotësuese ose ndihmëse që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

Komunikimi vertikal në objektin e parashikuar të ndërtohet/rikonstruktohet është konceptuar të zgjidhet nëpërmjet impianteve ngritëse dhe transportuese siç janë ashensorët. Në objekt është parashikuar furnizimi dhe montimi i ashensorit. Ky element strukturor është paraqitur në të gjitha paraqitjet grafike në planimetri dhe altimetri, sikurse edhe në preventivin e punimeve për zbatimin.

Punimet për montimin e ashensorit në vepër dhe vendosjen e tij në funksion duhet të kryhen nga subjekte, të cilat referuar legjisllacionit duhet të zotërojnë licensën e posaçme për impiante ngritëse dhe transportuese. Nisur nga vlera e këtyre punimeve në preventiv, të tilla punime janë përcaktuar në kategorinë A, në përputhje me VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar.

N.S - 4 B Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me material druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese.

Sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar me punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me material druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i muraturës dhe mureve ndarës të çfarëdo lloji, tipi, përfshirë suvatimin, patinimin, bojatisjen dhe punime të ngjashme me to. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i karpenterisë dhe punimeve prej druri, të dyerve dhe dritareve të brendshme dhe të jashtme, të veshjeve të brendshme dhe të jashtme të dyshemeve të tipeve të ndryshme dhe me materiale të ndryshme dhe të punimeve të realizuara me dorë, me metal, dru, material plastik dhe material xhami ose të ngjashëm. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i izolimit termik dhe akustik, nënçatitë dhe mbrojtja nga zjarri, izolimi i natyrave të ndryshme dhe me materiale të ndryshme.

Vendosja e këtij kriteri u referohet punimeve të parashikuara në projektet teknike, relacionet teknike, specifikimet, preventivin dhe grafikun e punimeve për zbatimin e veprës. Këto punime parqiten të detajuara në projektin arkitekturor dhe specifikimet e punimeve ndërtimore. Punimet e parashikuara në këtë dokumentacion teknik përfshijnë punime suvatimi, punime dyersh dhe dritaresh, të veshjeve të brendshme dhe të jashtme të dyshemeve të tipeve të ndryshme, punimeve shtresash me pllaka dhe punime të ndryshme izolimi. Vëllimi dhe vlerat e punimeve të tilla janë të konsiderueshme. Tipologjia e mureve, veshjeve, rifiniturave, dyerve dhe dritareve në objekt është e larmishme. Për zbatimin e punimeve të tilla, VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar, përcakton se duhet të disponohet licensa NS-4.

Nga sa më sipër, duke marrë në analizë të gjithë dokumentacionin teknik, specifikën e punimeve dhe vlerat e të gjithë punimeve të tilla në preventivin total të kësaj ndërhyrjeje, u vendos si kriter teknik profesional licensa NS-4 D, e cila është e domosdoshme për vlerën, rëndësinë dhe kompleksitetin e punimeve të tilla.

N.S - 12 B Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit.

Sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar punime të tilla konsiderohen montimi dhe mirëmbajtje ose ristrukturimi i një sistemi të plotë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të klimës, të impianteve pneumatike, të kompletuara me punimet murature, plotësuese ose ndihmëse, për të realizuar bashkimet ose ndërhyrjet që i përkasin kategorive të përgjithshme që janë realizuar ose janë në proces realizimi.

Referuar VKM Nr. 418, datë 10.5.2017 “Për Standardet, Kriteret dhe Procedurat për Hapjen, Riorganizimin, Ndarjen, Bashkimin ose Mbylljen e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe të Degëve të tyre”, Pika 2.c.) Standarde dhe normativa për infrastrukturën e IAL-së, paragrafi ë):

ë) Mjediset e IAL-ve duhet të jenë të pajisura me sisteme funksionuese ngrohje-ftohjeje.

Objekti i parashikuar të ndërtohet do të pajiset me sistem të plotë HVAC. Sistemi i propozuar në projektin HVAC është konceptuar posaçërisht për funksionin e Shkolles 9-vjecare "Ismail Qemali". Impianti i projektuar nëpërmjet këtij projekti është parashikuar - Impiant hidrik primar me prurje variabël dhe sekondar me prurje variable. Komforti termik, qarkullimi i mirë i ajrit dhe lagështia relative e krijuar në ambient është shumë e rëndësishme në objektet e kësaj natyre. Në projektin mekanik HVAC, duke përfshirë zgjidhjet grafike, relacionin teknik, specifikimet teknike, si dhe pjesën përkatëse të preventivit dhe grafikut të punimeve për realizimin e secilit seksion të ndërtesës janë parashikuar të gjitha punimet për ndërtimin e rrjeteve, furnizimin dhe montimin e këtij sistemi. Për realizimin e këtyre punimeve në kriteret teknike është kërkuar që OE të zotërojë kapacitetet teknike profesionale për zbatimin e sistemit të plotë të ngrohjes, ftohjes dhe ventilimit, në përputhje me zgjidhjet teknike të hartuara nga projektuesi. Vendosja e këtij kriteri kushtëzohet nga punimet e parashikuara të realizohen për kompletimin dhe përmbylljen e veprës. Nisur nga natyra e punimeve dhe vlerat e preventivit për zbatimin e tyre, është e domosdoshme që OE të jetë i pajisur me licensën respektive N.S - 12 B, sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar.

N.S - 14 B *Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV.*

Me impiante të kësaj tiplogjie, në shtjellim të N.S – 14 *konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV, si edhe të linjave të transmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t'u realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.*

Projekti i zbatimit parashikon ndër të tjera zbatimin e punimeve për rrjetet elektrike dhe elektronike, të tilla si punimet për instalimin e rrjetit elektrik të furnizimit me energji, ndriçimin, rrjetin lan ,etj pajisje sistemi i zbulimit dhe lajmërimit të zjarrit.

Punime të tilla duhet të realizohen nga subjekte të kualifikuar për realizimin e tyre, në përputhje me VKM nr.42 të datës 16.01.2008, më sipër cituar. Licenca e nevojshme për realizimin e këtyre punimeve, referuar këtij akti është N.S - 14 - Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV. Kategoria B i referohet vlerës së punimeve të tilla në preventivin e punimeve.

N.S - 18 A *Punime topogjeodezike.*

Punime të tilla përfshijnë zbatimin e rievimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, *punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.*

Sikurse shtjellohet në specifikimet teknike të punimeve ndërtimore, pika 1.5/a, mbështetur në dokumentacionin topografik të hartuar nga projektuesi dhe dokumentacionin e pronësisë së objektit, Kontraktori duhet të kryejë transferimin e pikave referenciale dhe gjurmës së objektit në terren, si dhe çdo shërbim tjetër topografik, të nevojshëm për zbatimin e saktë të projektit.

Objekti i parashikuar të ndërtohet ka një planimetri sheshi dhe një kufi prone me formë të thyer, planimetritë e tij zhvillohen në disa nivele dhe disnivele, volumetria është komplekse dhe vështirësisë së të gjithë këtyre aspekteve u shtohet se godina është projektuar me një kat të “zhytur” 2.1m nën nivelin e tokës, për shkak të gjendjes së gjeologjisë së sheshit. Zbatimi jo i saktë i të projektit në të gjitha nivelet mund të çojë në dëme kolosale dhe pamundësi teknike për realizimin e duhur të këtij konstruksioni.

Kategoritë janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategori a e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
N.P-1 A	Punime gërmimi në tokë	Gërmim dheu themele e plinta me b-2m, ekskavator me zinxhir 0.25m3,shkarkimi ne auto Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km	0-20 mln leke	3.340.522,66

		Germim themel i vecuar, gropa me sip. 10-30 m ² , ne toke e zak. me h = 1.5 m Germim dheu gropa shtylla toke e bute kat I-II sip ~1.5m Germim e mbushje dheu me krah per kanale h deri 1.5m		
N.P-2 D	Ndertime civile dhe industriale	Shtrese betoni C 12/15 Shtrese betoni C25/30 Shtrese stirobetoni Shtrese lluster cemento 1:2 Shtrese polistireni termoizoluese dhe dhenie pjerresie ne tarace Shtrese betoni C16/20 me zgare hekuri Pllake themeli, trare e bazamente b/a C 25/30 Trare e arkitrare b/a C20/25 h ~ 4m Kollona b/a monolite C 25/30 h ~ 4m Soleta b/a me polisterol dhe rrjete teli C 20/25 t=30cm, h~6m Mure b/a t = 11-20cm h ~ 4m C 16/20 Breza b/a monolit C 16/20 Mur betoni C 16/20 Themel e xokol butobetoni C16/20 Kapuç betoni monolit C 12/15 mbi mure F.V. Hekur betoni periodik Ø > 12 mm F.V. Hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm F.V. Hekur betoni periodik, Ç- 5, Ø > 12mm F.V. Hekur betoni i zakonshem Ø 6 ~ 10mm Konstruksione metalike te thjeshta Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 k katrama Shtrese termoizoluese me polisterol t=10 cm Shtrese lluster cemento 1:2 t = 20 mm Hidroizolim me emulsion dhe 2 bitum Parapet shkalle e ballkone me tuba inoksi ngjyre e verdhe ose metalizato h = 80 ~ 90 cm F.V. Porte metalike dekorative rreshqitese F.V. Zgara dekorativa hekuri mesatare	101-200 mln leke	101.076.997,75
N.S- 1. A	Punime për prishjen e ndërtimeve	Prishje mur tulle pa pastrim Prishje mur guri Prishje soleta b/a Prishje trotuari ekzistues Prishje shtresa betoni Prishje shtresash ekzistuese, t=10cm.	0-20 mln leke	16.373.589,31
N.S- 2. A	Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre	F.V. Bolier 80 liter, uje te ngrohte F.V. Bolier 12 liter, uje te ngrohte sanitar F.V. WC allafrenga F.V. Lavaman porcelani F.V. Pilete dysHEMEJE Ø 50 F.V Tabele sinjalistike - Drejtim dalje ndriçuar ne 1 ane F.V Tabele sinjalistike - Drejtim dalje ndriçuar ne 2 ane F.V Tabele sinjalistike - Hidrant Zjarri i brendshem F.V Tabele sinjalistike - Fikse zjarri me pluhur 6 kg F.V Tabele sinjalistike - Fikse zjarri me CO2 6 kg F.V Tabele sinjalistike - Dalje e emergjences shkalleve F.V Tabele sinjalistike - Ndalim shuarje me uje , Pajisje Elektrike Nen Tension F.V Bombul me pluhur per shuarje e zjarrit me kapacitet 6 kg, kompletuar me gjithë aksesoret per montimin ne	0-20 mln leke	6.182.040,02

		<p>F.V Bombul me CO2 per shuarje e zjarrit per pajisjet nen tension me kapacitet 6 kg, kompletuar me gjithë aksesoret per montimin ne mur.</p> <p>F.V.Saraçeneska Flutur,me dimensione DN 100,PN 10 Bar, F.V.Saraçeneska Flutur,me dimensione DN 80, PN 10 Bar, F.V.Saraçeneska Flutur,me dimensione DN 65, PN 10 Bar, F.V.Saraçeneska Flutur,me dimensione DN 50, PN 10 Bar, F.V.Xhunto Antivibruese,me dimensione DN 80, PN 10 Bar, F.V.Xhunto Antivibruese, me dimensione DN 65,PN 10 Bar, F.V.Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=75mm, Pn 16 F.V.Tuba e rakorderi PPR Pn 20 f = 75 x 6.4 mm F.V. Tub plastik, PE-Xa 16x2, i termoizoluar ne fabrike. Kompletuar me gjithë, unaza bashkuese, "T" per ndarjen e degeve, reduksione, brryla, dhe te gjitha elemtet e tjere te nevojshem per montim.</p> <p>F.V Set kolektorësh per furnizimin me uji te ftohthe/ngrohte DN 25, dalje DN15 (9+3), kompletuar me gjithë saraceneskat ne hyrje dhe niples DN15 ne dalje si dhe kutiplastike dhe suportet e kolektori per montimin</p> <p>F.V Set kolektorësh per furnizimin me uji te ftohthe/ngrohte DN 20, dalje DN15 (4+2), kompletuar me gjithë saraceneskat ne hyrje dhe niples DN15 ne dalje si dhe kutiplastike dhe suportet e kolektori per montimin</p> <p>F.V Set kolektorësh per furnizimin me uji te ftohthe/ngrohte DN 20, dalje DN15 (3+2), kompletuar me gjithë saraceneskat ne hyrje dhe niples DN15 ne dalje si dhe kutiplastike dhe suportet e kolektori per montimin</p> <p>F.V Set per tualetin e personave me aftesi ndryshe (tetraplegjik) WC+Lavaman+mishelator lavamani kompletuar me te gjitha aksesoret ndihmes.</p> <p>F.V Tub I Brinjezuar (Corrugato) D125 kompletuar me aksesoret per montim.</p> <p>F.V Tub I Brinjezuar (Corrugato) D160 kompletuar me aksesoret per montim.</p> <p>F.V Tub I Brinjezuar (Corrugato) D200 kompletuar me aksesoret per montim.</p> <p>F.V Tub shkarkimi PP me gota D160 kompletuar me gjithë rakorderite dhe aksesoret e nevojshem per</p> <p>F.V Tub shkarkimi PP me gota D125 kompletuar me gjithë rakorderite dhe aksesoret e nevojshem per</p> <p>F.V Tub shkarkimi PP me gota D110 kompletuar me gjithë rakorderite dhe aksesoret e nevojshem per</p> <p>F.V Tub shkarkimi PP me gota D 50 kompletuar me gjithë rakorderite dhe aksesoret e nevojshem per montim.</p> <p>V. Hidrant Zjarri i jashtem UNI 45 shiko detajet tek specifikimet</p> <p>F. Stacion pompimi per sistemin e mbrojtjes ndaj zjarri e kompozuar nga dy pompa elektrike referuar normes EN 12845, - Pompa Motor Elektrik Prurja:V=14.4 m³/h Presioni:H=50 mkH₂O Fuqia:15 kW Rryma:27.1 A Lidhja elektrike, 3~400 V, 50 Hz -</p> <p>Pompa e Proves me Motor Elektrik Fuqia:</p> <p>F. Hidrant Zjarri Mural DN 45 UNI-EN 671-2 (Marke CE)</p>		
--	--	---	--	--

		Central Zjarri i Adresueshem i kompozuar, i kompletuar me 4 Loop, i certifikuar EN 54-2, EN 54-4. Mundesi zgjerimi deri ne 8 loop. Mundesi per te ndare ne 2000 zona. Te ruaj deri ne 10000 ngjarje. Set kablllo modul kontrolli-bateri. Set kablllo modul kontrolli-UPS. Kavallote lidhje skedash 2 vende. Kavallote lidhje skedash 4 vende. Bateri 12V 38-45Ah, aksesore per vendosje ne mur.		
N.S-3. A	Impiante ngritëse dhe transportuese(ashensorë,shkallë lëvizëse transportues	Montim Ashensor per 4 persona me kater ndalesa Furnizim Ashensor per 4 persona me kater ndalesa	0-20 mln leke	2.512.000
N.S-4. B	Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifinitura me material druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese	Shtrese me pllaka grez importi, 40x40cm Shtrese me pllaka mermeri t=2cm Shtrese me pllaka porcelanat F.V. Dritare d/alumini plastike me dopio xham F.V. Vetrare d/alumini plastike me dopio xham F.V. Dyer d/alumini plastike me dopio xham Dyer d/alumini tek xh. F.V. Dyer te brendeshme tamburate te rimesuara Dyer te blinduara Veshje me pllake majolike Plintuse pllake grez Suva solete ~ 4 m, me drejtues, me pompe Suva brenda mur tulle ~ 4m, me pompe, ll perzier M 25 Veshje muri me polisterol te thjeshte t=5cm rrjete+suva. Veshje muri me kartonxhes Mur me tulla me 6 vrime, t=12cm h~3m, ll perz M 15 Mur me tulla te lehtesuara deri - 3 m, LL.P. M-25 Boje hidroplastike cilesi e larte F.V Dyer Industriale me grilla F V flete metalike te perforuara FV. Tavolina/ Banka për klasa shkollë 9 vjeçare FV. Karrike për klasa shkollë 9 vjeçare FV. Dollapë për klasa me gjerësi 60 cm FV. Tavoline per mesues me permasa 1400 x 700 x 900 mm FV. Karrige, stukturë metalike, mbështetëse PP,ulëse tekstili 52x47xH90 cm per tavolinën e FV. Tabelë e zezë për të shkruajatur me shkumës me permasa 2500-3000mm x 1200mm FV. Karrike për klasa shkollë 9 vjeçare Fv. Tavolina për laboratorin e fizikës me strukturë metalike sipas specifikimeve teknike i pajisur me të gjithë komponentët për katër nxënës FV. Karrige, stukturë metalike, mbështetëse PP,ulëse tekstili 52x47xH90 cm per tavolinën e Fv. Tavoline per mesues me permasa 1400 x 700 x 900 mm FV. Tavolina studimi për bibliotekë për 6 persona FV. Dollapë për klasa me gjerësi 60 cm FV. Tavolina kompjuteri për sallën e Informatikës/mesueve FV. Karrike me rrota për tavolinë kompjuteri FV. Tavolinë pune drejtori dhe nëndrejtori në	101-200 mln leke	107.658.630,33

		<p>FV. Karrike Zyre drejtori dhe nëndrejtori FV. Karrike Vizitori FV. Dollap për ruajtjen e dokumnetave FV. Komodine 45x50x60cm FV. Kolltuk tek FV. Tavolinë mesi 55x100x45cm Tavolinë për sallën e mësuesve ku do të akomodohen 18 persona FV. Karrike Vizitori FV. Karrike për klasa shkollë 9 vjeçare FV. Tavolina/ Banka për klasa shkollë 9 vjeçare FV. Karrige, stukturë metalike, mbështetëse PP,ulëse tekstili 52x47xH90 cm per tavolinën e Fv. Tavoline per mesues me permasa 1400 x 700 x 900 mm FV. Karrike për klasa shkollë 9 vjeçare Fv. Tavolina për laboratorin e bio/kimisë me strukturë metalike sipas specifikimeve teknike i pajisur me të gjithë komponentët për 4 nxënës FV. Karrige, stukturë metalike, mbështetëse PP,ulëse tekstili 52x47xH90 cm per tavolinën e Fv.Tavoline per mesues me permasa1400 x 700 x 900mm Tavolinë për sallën e aktiviteteve ku do të akomodohen 6 persona FV. Karrike Vizitori FV. Poltrone per fjalime FV. Karrige, stukturë metalike, mbështetëse PP,ulëse tekstili 52x47xH90 cm per tavolinën e FV. Karrike Vizitori FV. Krevat Pacienti Fv.Tavoline per mesues me permasa1400 x 700 x 900mm</p>		
N.S – 12 B	Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit;	Punime per sistemin HVAC	21-50 mln leke	29.643.064,84
N.S – 14 B	Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.	Punime civile per instalimet elektrike, IT, tokezime Kuadri elektrik Labororet smart Kuadri elektrik Kryesor dhe i kateve Instalimet elektrike ndriçim priza etj Instalimet e sistemit te sinjalizimit MNZ Instalimet e sistemit te internetit kamera IP dhe TV Pajisje elektrike per ndriçimin Pajisje sisteme IT dhe sinjalizimeve	21-50 mln leke	28.316.576,13
N.S–18. A	Punime topogjeodezike	RILEVIM TOPOGRAFIK, Ne referim termat e references	0-20 mln leke	

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet te jete i licensuar nga QKB me

- Licencë kategoria III.2.B për “Grumbullim, transportim, ruajtje/magazinim, rikuperim te mbetjeve te llojeve te ndryshme"
- Licence I.2.A "Sherbime Ekspertize dhe/ose profesionale te mbrojtjes civile" per sistemet e ekspertizes teknike kundra zjarrit.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, licencat e mesiperme duhet te disponohen nga nga anetari qe do te kryejë sherbimet perkatese).

Argumentimi Ligjor dhe Teknik : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM. nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Vendim Nr. 538 date 26.05.2009 ”Per licencat dhe lejet qe trajtohen nga apo nepermjet Qendres Kombetare te Licencimit (QKL) dhe disa rregullime te tjera nenligjore te perbashketa”. si dhe ne permbushje te detyrimeve ligjore qe percakton Ligji 10431 date 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” (te ndryshuar).

Ky kriter synon mbrojtjen e mjedisit dhe shendetit nga ndotja dhe demtimi prej mbetjeve te ngurta, nepermjet administrimit mjedisor te tyre ne cdo faze, perfshi krijimin, grumbullimin, ndarjen, ruajtjen, transportin, riciklimin, perpunimin, magazinimin, asgjesisimin, te cilat cojne ne pakesimin e mbetjeve dhe zvogelimin e ndikimeve te tyre te rrezikshme e te demshme. Duke qene se ne preventivin e punimeve jane pasqyruar punime prishje, germimi eshte gjykuar qe subjekti duhet te kete lejen e posacme per veprimtari te tilla si Stacionim transferimi per mbetjet nga prishjet dhe ndertimet, per mbetjet e ngurta urbane dhe magazinim i perkoshem i tyre.

Kërkesa per Licence I.2.A është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM. nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Vendim Nr. 538 date 26.05.2009 ”Per licencat dhe lejet qe trajtohen nga apo nepermjet Qendres Kombetare te Licencimit (QKL)

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat/lejet profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e proceseve te punes te parashikuara ne preventivin objekt kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente

2.3.4. Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktojë **Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt sipas Neni 8**, i cili duhet të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Bashkelidhur deklaratës për Drejtuesin Teknik duhet të paraqitet; a) Kontrata e punës e vlefshme dhe b) Diploma.

Ne rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt se ai eshte i disponueshem për realizimin e kësaj kontrate ne varesi te vleres se preventivit te punimeve qe ka marre persiper sipas përqindjes se bashkepunimit.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Ligjor dhe Teknik : Kjo kërkesë mbështetet ne nenin 77, pika 4 te Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), si dhe në nenin 39, pika 6, gërma “c” te VKM-se Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Duke qenë se objekt prokurimi është kontratë pune, sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi Udhëzimi Nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, konkretisht pika 1.2 ku citohet se: “drejtuesit ligjore dhe teknik te sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në

përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi” si dhe pikës 2.1 ku citohet se “drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejtë nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit. Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”. Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dispozitave ligjore në fuqi.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, ***drejtues teknik në licencën e shoqërisë ofertuese***, si më poshtë:

- Inxhinier Ndertimi 2(dy)
 - Inxhinier Ndertimi profili Strukturist 1(një)
 - Inxhinier Elektrik 1(një)
 - Inxhinier Mekanik 1(një)
 - Inxhinier Hidroteknik 1(një)
 - Inxhinier Elektronik 1 (një)
 - Inxhinier Gjeodet 1 (një)
 - Arkitekt 1(një)
- Inxhinierët e sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në licencën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesat e shoqërisë për te pakten 3 muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Për inxhinierët duhet të paraqiten: Diploma, Kontratë individuale pune (*e vlefshme*), librezë pune, C.V.

Murator dhe Suvatues -Punimet e muraturës në objektin që ndërtohet parashikojnë ndërtimin e të gjithë mureve në vëllimet që ndërtohen si dhe suvatimet e jashtme dhe te brendshme, përzgjedhin materialet e nevojshme dhe veglat e punës para fillimit të procesit të punës, respektojnë me rigorozitet radhën e kryerjes së çdo procesi pune sipas orientimit të dhënë në objekt, bëjnë përgatitjen e sasisë së nevojshme të llacit për procesin ditor të punës, duke respektuar porcionet e duhura të materialeve përbërëse, bëjnë breza përforcues betoni në gjysmën e lartësisë së murit ose sipas specifikimit në projekt, kontrollojnë nëse muret janë të lidhur midis tyre horizontalisht dhe vertikalisht duke garantuar kështu qëndrueshmërinë e tyre, ndërtojnë soletat, vendosin arkitrarët e dyerve dhe dritareve, vendosin kondrakasat e dyerve dhe dritareve, nëse ka të tilla të parashikuara në projekt, bëjnë mbushjen me llac të mureve në nivelin e fashove me dorë ose me pompë në varësi të materialit të përcaktuar nga drejtuesi teknik në objekt, përgatitin materialin e nevojshëm për tavane me gips apo për tavane të varura zbukurues duke bërë matjet dhe prerjet e duhura, bëjnë stukime apo riparimet e duhura të objekteve të ndryshme, bëjnë kontrollin përfundimtar të punimeve, duke u siguruar që gjithçka është sipas përshkrimit në projekt etj. Konkretisht per kryerjen e ketyre punimeve duhen *gjithesej 37.441 /8/352=13.29 punonjes*. Afati I punimeve eshte 16 muaj dhe kemi qe per realizimin ne aftat teketyre punimve duhen 13 punonjes nga te cilet 50% duhet te jene teknike te specializuar pra per kete rast kerk ohen 6 specialiste muratorë/suvatues.

Pllakashtrues -. Punimet e parashikuara në këtë projekt parashikojnë shtrimin e të gjitha dysHEMEVE të kateve, shtrimin e sipërfaqeve të shkëlme të shkallëve, shtrimin me pllaka të mureve të tualeteve etj. Këto punime në preventiv pëfshijnë sipërfaqe të mëdha. Konkretisht per kryerjen e ketyre punimeve duhen *gjithesej 19.318.52/8/352=6.86* . Afati I punimeve eshte 16 muaj dhe per realizimin ne aftat te ketyre punimve duhen 7 punonjes nga te cilet 50% duhet te jene teknike te specializuar pra per kete rast kerkohen 3 specialiste pllakashtrues.

Specialist punime gipsi -Do te kryeje punimet e ndertimit te mureve me kartonxhes etj. duhen *gjithesej 1.237 /8/352=0.44 punonjes*

Specialiste punime durale .Do te realizoje vendosje e dyerve te brendshme, dyerve te blinduara, vetratave etj. Konkretisht per kryerjen e ketyre punimeve duhen *gjithesej 2.789.61/8/352=0.99 punonjes*

Saldatori -Sherben për saldimin e elementëve metalikë.Ne zerat e preventivit parashikohen realizime te strukturave metalike. Konkretisht per kryerjen e ketyre duhen *gjithesej 591.16/8/352=0.21 punonjes*. Pra per kryerjen e ketyre punimeve eshte e domosdoshme prania e 1 (nje) saldatori.

Specialist konstruksione metalike - Sherben për konstruksionet me elementëve metalikë Ne zerat e preventivit parashikohen realizime te strukturave metalike.Konkretisht per kryerjen e ketyre punimeve

duhen gjithesej $959.54/8/352=0.34$ punonjes. Pra per kryerjen e ketyre punimeve eshte e domosdoshme prania e **1 (nje) specialisti konstruksionesh metalike.**

Mekanik -Ne preventiv pëfshihet projekti i rrjetit HVAC dhe projekti mekanik i mbrojtjes nga zjarri dhe parashikohen punime të tilla si punime për instalimin e rrjetit të tubave të ujit, të valvulës autoballancuese dhe kontrolluese, të centralit termik, punime për montimin e pajisjeve të kondicionimit, të pajisjeve të ajrit të freskët dhe ventilimit, si dhe punime për instalimin e sistemit MKZ dhe instalimin e pajisjeve respektive. Të tilla punime do të realizohen në të gjithë vëllimet e objektit që ndërtohet. Konkretisht per kryerjen e ketyre punimeve *duhen gjithesej $623.66/8/352=0.22$ punonjes.* Pra per kryerjen e ketyre punimeve eshte e domosdoshme prania e **1 (nje) mekaniku**

Punetor te thjeshte ndertimi.Do te kryejne sipas zerave te preventivit punime prishjeje,germime,hedhje dhe mbulim me materiale te kanaleve etj. Konkretisht per kryerjen e ketyre punimeve *duhen gjithesej $37278.82/8/352=13.24$ punonjes.*

2.3.10 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht :

- **3 punonjës manovratorë** të mjeteve të rënda (2 automakinist dhe 1 eskavatorist) .
- **2 shofer kamioni.**

Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmite e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse. (*Manovratorët mund të disponohen se bashku me mjetet perkatese nese merren me qira.*)

Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B , operatorët ekonomik duhet të deklarojnë per punonjesit eskavatoriste, automakinist dhe shofere, emer/mbiemer, profil i punes, numri dhe daten e kontratës individuale të punës, si dhe numrin dhe afatin e vlefshmerise se deshmise së aftësisë profesionale.

Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese punojesit e mesiperem, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Kur mjetet janë marrë me qira nga persona fizik, të cilat janë në pronësi të këtyre të fundit, atehere manovratorët, automakinistet dhe shoferet nuk ka nevojë që të figurojnë në listëpagesat përkatëse të O.E. ofertues.

Shënim: Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentim Ligjor dhe Teknik : Në kriterin mesipercituar është kërkuar që OE të kenë të punësuar teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, sipas fushave që përfshijnë punimet për zbatimin e projektit.

Këtu përfshihen kërkesat për punonjësit, të cilët janë trajnuar/certifikuar për kryerjen e punimeve të caktuara të zbatimit, pasi kanë kryer me sukses kurse dhe trajnime profesionale për punimet respektive. Zbatimi i punimeve që përfshin projekti duhet të kryhet nga fuqi punëtore e kualifikuar për secilën

tipologji punimesh. Punëtorët e ndërtimit dhe profesionet e lidhura me to ndërtojnë, mirëmbajnë dhe riparojnë ndërtesat dhe strukturat e tjera që nga themelet, muret dhe pjesët të tjera kryesore të ndërtesës dhe konstruksione të tjera, si jashtë ashtu edhe brenda duke përdorur teknika dhe materiale tradicionale apo moderne të ndërtimit. Ata kryejnë punime murature, suvatime, shtrim pllakash dhe parketesh, lyerje me bojë etj. Nisur nga punimet e parashikuara të zbatimit, në kriteret e veçanta janë kërkuar punëtorët e kualifikuar si vijon:

Për manovrimin e makinerive mbi bazë automjeti, ku përfshihen autovinça, autobetoniere, autopompe betoni, autobot uji është kërkuar kategoria e punonjësve të kualifikuar automakinist.

Kjo kërkesë mbështetet në kategorizimet e përcaktuara në Urdhërin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 200, datë 16.5.2019 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit”, neni 8, pika 1c që përcakton se, *automjete për përdorim të veçantë (APV) sipas pikës “g”, të nenit 54, të Kodit Rrugor, makineri ndërtimi mbi bazë automjeti: -autovinça, autobetonierë, autopompa betoni, autobitumatriçe, autosonda, autotokmak manovratorëve u jepet dëshmi për AUTOMAKINIST. Për manovrimin e të cilave janë kërkuar **2 (dy) automakinistë**. Ky numër automakinistësh është kërkuar minimal në raport me nevojat, duke patur për qëllim rritjen e pjesëmarrjes. Proceset e lidhura me këto automjete janë thuajse të njëkohëshme. Përdorimi i ketyre makinerive mund të alternohet sipas programit të punës për zbatimin e kontratës.*

Për manovrimin e makinerive të gërmimit dhe ngarkimit të dherave ku përfshihen minifadromat dhe fadromat e llojeve të ndryshme dhe eskavatorët e ndryshëm janë kërkuar eskavatoristë.

Kjo kërkesë mbështetet në kategorizimet e përcaktuara në Urdhërin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 200, datë 16.5.2019 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit”, neni 8, pika 1a, sipas së cilës, *eskavator gërmimi e ngarkimi dherash: - të të gjitha llojeve si dhe fadromat e të gjitha llojeve (me goma dhe me zinxhirë), manovratorëve u jepet dëshmi për ESKAVATORIST.*

Për punimet e gërmimit do të punojnë një eskavatorë me zinxhir. Për këtë arsye do të nevojitet një eskavatorist. Duke patur parasysh volumet e punës dhe përdorimin e eskavatorit sipas nevojave është e mjaftueshme kërkesa për **1 (një) eskavatoristë**.

Kjo kërkesë është minimale në raport me punën e nevojshme. Kujtojmë se sipas nenit 17 të urdhrit më sipër cituar, *për të mundësuar lëvizjen në rrugë dhe për të shmangur aksidentet, mjetet për të cilat bën fjalë neni 8 i kësaj rregulloreje duhet të qarkullojnë në përputhje me përcaktimet e nenit 113 të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. Ndërsa referuar nenit 8, pika 2, të po këtij akti, për lëvizjen apo qarkullimin në rrugë, makineritë e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, nëse janë të pajisura me rrota pneumatike, duhet të plotësojnë kërkesat e nenit 113 dhe 122 të Kodit Rrugor, kurse drejtuesit e tyre, në varësi të makinerisë, duhet të jenë të pajisur me kategorinë përkatëse të lejdrejtimit.*

Gjithashtu për përdorimin e kamioncinave është kërkuar **2 (dy) shofere kamioni**. Ky numër shoferesh është kërkuar minimal në raport me nevojat, duke patur për qëllim rritjen e pjesëmarrjes

Percaktimi i numrit të punonjësve dhe profesionet është bazuar mbi zerat dhe volumet e punës si dhe afateve për përfundimin e punimeve, në mbështetje të Manualit të ndërtimit miratuar me Vendim Nr. 216, datë 13.4.2023. **Bazuar në kater elementet e struktures se kostos(material, puntori, makineri, transport).** Numri i punonjësve, dhe profesionet që nevojiten për realizimin e kontratës është

përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore

2.3.11 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose marrëveshje bashkëpunimi me prodhuesin, ose autorizim distributori për pajisjet e meposhtme. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet edhe marreveshja ndermjet prodhuesit dhe distributorit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij

Ashensor, Certificate per ashensorët e personave sipas standartit SSH EN 81-20:2020 dhe direktives 2014/33/EU e leshuar nga organe te akredituara kombetare ose nderkombetare. Certifikata te shoqerohet bashke me certifikaten e akreditimit te organit te akredituar. Katalogu ose fragmente te katalogut

*Transformator 10- 20 / 0.4 kV - 2500kVA me regullator tensioni
Te paraqitet certifikate/deklarate nga prodhuesi qe verteton qe transformatori ploteson standardet SSH /IEC 60076 - Sistemet standarde per transformatoret e fuqise.
Katalogu ose fragmente te katalogut*

Grup me dy pompa INVERTER (me nje pomp rezeve) per frunizimin me uji sanitar. 1. Prurja e ujit:18m³/h 2. Presioni:55 mkh/20 3. Lidhjet elektrike:3~400 V, 50 Hz 4. Lidhjet Hidraulike:DN 65 5. Fuqia Elektrike:3.0 kW . Te paraqitet skedat teknike/kataloge te shoqeruara me raportet e testimit nga laboratore te akredituar ose certifikata aprovimi/performance

Ene zgjerimi Autoklave per pompen ujit sanitare. -Volumi i depozitave:500 lit - Presioni i karikimit:2.5 bar - Presioni Max16 bar - Lidhjet Hidraulike: DN 32 (Ø 1 1/4") - Dimensionet: Ø775x1360 mm. Te paraqitet skedat teknike/kataloge te shoqeruara me raportet e testimit nga laboratore te akredituar ose certifikata aprovimi/performance

Stacion pompimi per sistemin e mbrojtjes ndaj zjarri e kompozuar nga dy pompa elektrike referuar normes SSH/EN 12845, - Pompa Motor Elektrik Prurja:V=14.4 m³/h Presioni:H=50 mkH₂O Fuqia:15 kW Rryma:27.1 A Lidhja elektrike, 3~400 V, 50 Hz - Pompa e Proves me Motor Elektrik. Te paraqitet skedat teknike/kataloge te shoqeruara me raportet e testimit nga laboratore te akredituar ose certifikata aprovimi/performance

Pajisje VRF e brendeshme Murale. Kapaciteti termik ne ngrohje/ftohje 2.2/2.5 kW me fryrje 324/282/240m³/h; 2.8/3.2 kW me fryrje 342/300/258m³/h; 3.6/4.0 kW me fryrje 426/342/276m³/h; 4.5/5.0 kW me fryrje 534/450/360m³/h; 5.6/6.3 kW me fryrje 708/600/492m³/h dhe 7.1/8.0 kW me fryrje 888/744/600m³/h, te kompletuara me gjithë rakorderite e nevojshme per montim. Te paraqitet skedat teknike/kataloge te shoqeruara me raportet e testimit nga laboratore te akredituar ose certifikata aprovimi/performance

Njesi e jashtme sistem VRF, me vazhdueshmeri ne ngrohje (continues heating), Inverter. Kapaciteti termik ngrohje/ftohje 61.6/69.3 kW; 67.2/75.6 kW; 80.0/90.0 kW; 90.4/101.7 kW dhe 107.2/120.6 kW, kompletuar me gjithë mbeshtetese pre gomine si dhe aksesoret e nevojshem per

montim. Te paraqitet skedat teknike/kataloge te shoqeruara me raportet e testimi nga laboratore te akredituar ose certifikata aprovimi/performance

Central Zjarri i Adresueshem i kompozuar, i kompletuar me 4 Loop, i certifikuar SSH/EN 54-2, EN 54-4. Mundesi zgjerimi deri ne 8 loop. Mundesi per te ndare ne 2000 zona. Te ruaj deri ne 10000 ngjarje. Set kablllo modul kontrolli-bateri. Set kablllo modul kontrolli-UPS. Kavallote lidhje skedash 2 vende. Kavallote lidhje skedash 4 vende. Bateri 12V 38-45Ah, aksesore per vendosje ne mur. Te paraqitet skedat teknike/kataloge te shoqeruara me raportet e testimi nga laboratore te akredituar ose certifikata aprovimi/performance.

Argumentimi Ligjor dhe Teknik : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar nën të 36, dhe 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nën të 40, pika 6 dhe 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfutuesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi apo nga distributori i autorizuar i tyre.

Paraqitja e autorizimit të prodhuesit ose marrëveshje bashkëpunimi ose autorizimit të distributorit të autorizuar për furnizimin e mallrave që do të ofertohen, është kërkesë ligjore e domosdoshme, me qëllim që OE të kenë autorizimin për tregtimin e produkteve nga prodhuesi apo distributori i autorizuar, apo marrëveshje bashkëpunimi, duke treguar origjinalitetin e tyre dhe ofruar garanci për mallrat që do të furnizohen.

Për nga vetë natyra e veçante e procedurës së prokurimit, me qëllim realizimin e kontratës që prokurohet, kriteri i sipërcituar është një kërkesë e nevojshme që lidhet drejtpërdrejt me rëndësinë dhe natyrën e objektit që prokurohet dhe që mund të plotësohet nga çdo operator ekonomik, cili ka kapacitetet e nevojshme për realizimin e procedurës. Gjithashtu OE duhet të paraqesin skedat teknike/katalogë për disa prej artikujve kryesor të objektit të prokurimit, ku të shprehin qartë secilin lloj të mallit që ofertojnë, për të gjykuar nëse malli që do të lëvrohen nga operatorët ekonomikë janë në përputhje të plotë me specifikimet teknike dhe se OE do të furnizojë me ato mallra që ka paraqitur në ofertën e tenderit dhe për të cilën do të jetë shpallur fitues. Kërkesa për skedat teknike/katalogë është vendosur për pajisjet që kanë një rëndësi të veçantë për AK dhe një vlerë të konsiderueshme.

Lidhur me paraqitjen e certifikates CE, Ak arsyeton se paraqitja e një çertifikate të tillë për pajisjen e kërkuar është e domosdoshme për vetë rëndësinë që ajo mbart, pasi verifikon zyrtarisht nga prodhuesi performancën e pajisjeve. Vendosja e këtij kriteri garanton AK se, pajisjet që do të furnizohen kanë performancë të çertifikuar, e cila konsiderohet thelbësore për të shmangur abuzimet apo ndërhyrjet në KW e përshtuar të pajisjes.

2.3.12 Ne përputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit perkates, operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim / kontrate bashkëpunimi nga prodhuesi / distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje / mallra në këtë procedurë prokurimi, si më poshtë:

- Materiale elektrike
- Materialet hidraulike
- Bojra

Për rastin kur autorizimi dotë jetë lëshuar nga distributori i autorizuar, duhet të shoqërohet edhe me dokumentacionin (kontratë/autorizim) që vërteton lidhjet e firmës prodhuese me distributorin

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

2.3.13. Ne perputhje me specifikimet teknike si dhe preventivin perkates për produktet e meposhtme duhet te paraqiten:

1. PUNIMET ELEKTRIKE

Kabell FG16OR16 Kabllot FG16OR16-0,6/1 duhet te jene sipas standardevSSH/e: CEI 20-13 SSH/IEC 60502-1 ose ekuivalente, SSH CEI UNEL 35318-35322-35016 ose ekuivalente; SSH /EN 50575:2014 + SSH /EN 50575/A1:2016 ose ekuivalente. Fleksibiliteti i bakrit duet te jete i klasit 5. Tensioni nominal U_0 duhet te jete 600V (AC). Tensioni nominal U duhet te jete 1000V(AC). Tensioni i tetimit duhet te jete 4000V. Tensioni maksimal U_m duhet te jete 1200V(AC). Temperatura maksimale e operimit duhet te jete 90 °C. Temperatura maksimale e lidhjes se shkurter duhet te jete 250 °C per seksione deri ne 240mm² Temperatura minimale e operimit duhet te jete -15 °C. Forca maksimale ne terheqje nuk duhet te jete me pak se 50N/mm². Duhet te paraqiten: **Skedat teknike/kataloge te shoqeruara me raportet e testimit nga laboratore te akredituar ose certifikata aprovimi/performance .**

Kablo bakri me izolim PVC, djeg.pa flake dhe emetim gazi, $U_n=0,6 / 1$ kV duhet te jene sipas standardeve: SSH /CEI 20-13 SSH/ IEC 60502-1 ose ekuivalente, SSH /CEI UNEL 35318-35322-35016 ose ekuivalente; SSH /EN 50575:2014 + SSH/ EN 50575/A1:2016 ose ekuivalente. Fleksibiliteti i bakrit duet te jete i klasit 5. Tensioni nominal U_0 duhet te jete 600V (AC). Tensioni nominal U duhet te jete 1000V(AC). Tensioni i tetimit duhet te jete 4000V. Tensioni maksimal U_m duhet te jete 1200V(AC). Temperatura maksimale e operimit duhet te jete 90 °C. Temperatura maksimale e lidhjes se shkurter duhet te jete 250 °C per seksione deri ne 240mm² Temperatura minimale e operimit duhet te jete -15 °C. Forca maksimale ne terheqje nuk duhet te jete me pak se 50N/mm² **Duhet te paraqiten: Skedat teknike/kataloge te shoqeruara me raportet e testimit nga laboratore te akredituar ose certifikata aprovimi/performance.**

Tub fleksibel PVC, djegje pa flake dhe emetim te ulet gazi, tip i rende, $\varnothing=20$ mm - 32 mm. Te gjeje perdorim ne te gjitha kategorite e instalimeve elktrike. Te plotesoje Standartin SSH /EN 61386-1 ose ekuivalente. Duhet te paraqiten: Skedat teknike/kataloge te shoqeruara me raportet e testimit nga laboratore te akredituar ose certifikata aprovimi/performance.

Ndricues plafonier / hermetik led Me driver LED te integruar. Te plotesoje Standartin SSH /EN 60598 ose ekuivalente. Duhet te paraqiten:Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me raportet e testimit nga laboratore te akredituar ose ekuivalente

Kaset + hidrant zjarri i brendshëm. Kasetë brenda murit, llamarine çeliku e emaluar me ngjyrë të kuqe, me baze rezine. Dimensionet (400x600x200) mm konform En 671-22012, tub fleksibël Dn 45 konform SSH /En 14540 ose ekuivalente, Aksesorët: saraqineske ndeërprerëse 1½", Duhet te paraqiten: **Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me raportet e testimit nga laboratore te akredituar ose ekuivalente .**

Fikëse zjarr pluhur karelato Bombel e lyer me boje ngjyre te kuqe (RAL 3000) e levizshme me pluhur. Mund te perdoret per fikjen e zjarrit ne pajisjet elektrike si dhe rreth tyre pasi eshte jo percielle. Efektive ne fikjen e zjarreve qe perfshin klasa A e zjarrit. Kapaciteti Normal 6 kg Diametri 190mm, lartesia 640 mm dhe me kapacitet 50 kg. Dim. 500 x 1100 x 600 mm dhe Te jete në përputhje me Standardin: SSH /EN 3-7 ose ekuivalente. **Duhet te paraqiten: Skedat teknike/kataloge te shoqeruara me raportet e testimit nga laboratore te akredituar ose certifikata aprovimi/performance.**

PUNIME BOJATISJE

Boje Hidroplastike ku të vërtetohet se produkti përmbush specifikimet teknike në përputhje me Standardin SSH: EN ISO 16000-9:2006/AC:2007 ose ekuivalente, lidhur me emetimin e komponentëve organikë të paqëndrueshëm (VOC), ku emetimi të jetë jo më poshtë se KLASA "A+", si dhe T.V.O.C < 1000µg/m³. - SSH EN ISO 6504-3:2007 ose ekuivalente, lidhur me aftësinë mbuluese (fshehëse) të bojës, ku fuqia mbuluese të jetë jo më pak se Klasa e I-rë.- SSH EN ISO 11998:2006 ose ekuivalente lidhur me rezistencën ndaj fërkimit të lagësht, ku rezistenca ndaj fërkimit të lagësht të jetë jo më pak se Klasa e II-të. Duhet te paraqiten: **Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me raportet e testimit nga laboratore te akredituar me ISO 17025 ose ekuivalente Certifikim ku të vërtetohet se produkti eshte boje ekologjike dhe antibakteriale.**

PUNIME SHTRESASH, SUVATIMI DHE VESHJE

Hidroizolues Material dykomponentesh me baze çimento dhe hidroizolues, elastik me funksion mbrojtës për terrace, themele, bodrume, etj. Produkti duhet te përmbushë specifikimet teknike në përputhje me Standardin SSH EN 14891:2017 ose ekuivalente, lidhur me produktet e lëngshme të papërshkueshme nga uji. Duhet te paraqiten: **Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me raportet e testimit nga laboratore te akredituar me SSH /ISO 17025 ose ekuivalente.**

Pllakë shtrimi grez porcelanato. Porcelain . Nuk duhet të jenë të lëmuara në mënyrë që të shmangët rrëshqitja. Duhet të jenë rezistente ndaj gërvishtjeve (kategoria 4) dhe të kenë koeficientin më të lartë të mundshëm kundër rrëshqitjes Duhet te paraqiten: **Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me Çertifikatë Konfirmimiti CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi .**

Veshje me pllakë majolike. Duhet te paraqiten: **Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me Çertifikatë Konfirmimiti CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi.**

Suva (Llac mbushës)- Produkti duhet te përmbushë specifikimet teknike në përputhje me Standardin SSH: EN 998-1 ose ekuivalente. Në rast se është produkt jo i gatshëm të deklarohet receptura përkatëse që vërteton se produkti përmbush specifikimet teknike të kerkuara edhe sipas SSH: EN 998-1 ose ekuivalente. Duhet te paraqiten:Kataloget/skedat teknike të shoqeruara me raportet e testimit nga laboratore të akredituar me SSH/ ISO 17025 ose ekuivalente

Fino Produkti duhet te përmbushë specifikimet teknike të kerkuara edhe në përputhje me Standardin SSH: EN 998-1 ose ekuivalente. Duhet te paraqiten:Kataloget/skedat teknike të shoqeruara me raportet e testimit nga laboratore të akredituar me SSH/ ISO 17025 ose ekuivalente.

PUNIME HIDRAULIKE.

Tuba PPR Tubat PPR duhet te jene te perbera prej materiali cilesor polipropileni si dhe me perberje polimeri (kopolimer) . Duhet te kene aftesi te mira te ruatjes se formes se tyre ndaj faktoreve te cilet ndikojne ne ndryshimet sasiore dhe vetite e materialit si fleksibiliteti dhe fluiditeti .Tubat duhet te jene te prodhuara sipas SSH EN ISO 15874-3 ose ekuivalente dhe te afta per te perballuar presione deri ne 25 bar ose 2.5 MPa. Dendesia e materialit Sipas standartit : SSH ISO 1183 ose ekuivalente. Elasticiteti I tubit sipas:ISO 527-2/1 ose ekuivalente. Fortesia e tubit sipas : SSH ISO 865 ose ekuivalente. Rezistenca ndaj goditjeve sipas: SSH ISO 179 ose ekuivalente. Percueshmeria termike sipas:DIN 52612 ose ekuivalente. Tubat PP-R duhet te jene te pershtatshem per tu perdorur ne linjat e ujit te pijshem dhe te jene te certifikuar me certifikate aprovimi te leshuar nga Institucion Nderkombetar ose Kombetar per perdorimin ne linjat e ujit te pijshem (p.sh DVGW).
Duhet te paraqiten: Kataloget/ skedat teknike te shoqeruara me Çertifikatë Konfirmiteti CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi.

Tubat e brinjzuar HDPE. Tubat e brinjzuar HDPE duhet të jenë nga material polietileni, me densitet të lartë, në përputhje me standartin SSH EN 13476 dhe SSH EN 1610 ose ekuivalente. Tubat duhet te kene fleksibilitet te mire dhe veti te mira hidraulike dhe mekanike .Duhet te jene te pershtatshme per te gjitha punimet ne sisitemet e kullimit dhe ujerave te zeza per instalime nentokesore me rezistence te larte kimike sipas klasifikimit te standartit SSH ISO 10358 ose ekuivalente. Gjatesia e tubave duhet te kete gjatesi standarte 6m dhe bashkimi i tyre te jete me bashkues me gomine EPDM ose SAG Tubat duhet te kene keto karakteristika. Materiali:HDPE Standarti:DIN 4262/1 ose ekuivalente Dendesia: >0.945 kg/m³ Moduli i elasticitetit:>800MPa Koficenti i zgjerimit termik linear:<0.17mm/m °K Koficenti i percjellshmerise termike:23 °C~0.36-0.5 W/mk Temperatura e Aplikimit:-40°C +60°C Rezistenca elektrike siperfaqesore:>1013Ω Forca e unazes:Sipas standartit SSH EN ISO 9969 ose ekuivalente. Ngjyra: E zeze Tubat hdpe te brinjzuar duhet te jene te certifikuar nga nje insitucion Nderkombetar ose Kombetar i akredituar,e cila te vertetoj qe tubat hdpe korrogato jane projektuar per kullime nentokesore nenpresion ne sisitemet e kanalizimeve. **Duhet te paraqiten: Kataloget/ skedat teknike te shoqeruara me Çertifikatë Konfirmiteti CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi .**

Tuba PVC-U Tubat pvc duhet te jene nga material pvc (klorur polivinil) me veti te mira mekanike me rezistence te larte dhe material shume I lehte per sisitemet e kanalizimeve sipas standartit SSH EN13476 ose ekuivalente. Tubat pvc duhet te jete me tre shtresa (shtrese e jashtme e lemuar, shtrese e brendshme e lemuar dhe shtrese me shkume klorur polivinil), ku shtresa e brendshme te kete vrazhdese te ulet dhe perfomace te mire hidraulike e,rezistence te larte ndaj grryerjes dhe antibakteriale.rezistente ndaj korrozionit ne mjedise alkaline, acide ose agresive dhe me jete gjatesi mbi 50 vjet.te kete qendrueshmeri te larte termike dhe rezistente ndaj ngarkesave te vazhdueshme termike deri ne 40°C.Shtresa e brendshme duhet te jete nga klorur polivinil i perfocuar me mbushes mineral e cila i jep tubit force dhe fleksibilitet.Shtresa e jashtme duhet te jete nga klorur polivinili portokalli e cila mundeson rezistence me te mire ndaj goditjes gjate trajtimit te instalimit te tubit.Tubat PVC jane te lire dhe te shpejte ne montimi duke lidhur skajet e tubave me bashkues. Transportimi I tyre behet ne menyre te thjeshte dhe te lehte. Unaza mbyllëse gome EPDM sipas SSH EN 681 ose ekuivalente.

Materiali:PVC.Struktura e tubit:me tre shtresa ose me nje shtrese. Densiteti: shtrese e lemuar $\geq 1.42-1.48\text{g/cm}^3$ Shtresa e shkumes $=0.8-1\text{ g/cm}^3$ Rezistenca e temperatures: 40-60°C, ku afatshkurter deri ne 60 °C dhe afatgjate deri ne 40 °C Zgjatimi linear Koeficient : $5 \times 10^{-5}\text{ mm/mm}^\circ\text{C}$ Rezistenca kimike:ph2-ph12Menyra e lidhjes: Prizë dhe unazë gome - rezistente ndaj rrjedhjeve deri ne presion 0.5 bar Elasticiteti:2.7-3.3 GPa Klasifikimi zjarrit:B2 ndezshmeri normale Fusha e aplikimit: varrosur brenda struktures se nderteses dhe jashte struktures se nderteses.Tuba PVC duhet te jene te certifikuar nga nje insitucion Nderkombetar ose Kombetar i akredituar e cila te vertetoj qe tubat PVC me tre shtresa jane te certrifikuara dhe i plotesojne te gjitha parametrat per kanalizimet e jashtme. Duhet te paraqiten: Kataloget/ skedat teknike te shoqeruara me Çertifikatë Konfirmiteti CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi.

PUNIME HIDROSANITARE.

WC duhet te jete e perbere prej porcelani cilesor.Materiali duhet te jete rezistent ndaj gershitjeve. Lartesia te jete nga 50- 70 cm , gjeresia te jete 30-40 cm.WC duhet te permbushin kerkesat funksionale dhe metodat e testimit sipas standartit SSH EN 997 2012 ,rezistencen e ngarkeses,pastrueshmerin,qendrueshmerin shkallen e rrjedhjes sipas normes SSH EN 997 2012 ose ekuivalente Duhet te paraqiten: **Kataloget/ skedat teknike te shoqeruara me Çertifikatë Konfirmiteti CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi.**

Lavaman Lavamani ngjyre e bardhe. Materiali porcelan. Te jete me lartesi 800-900mm. Te kete gjeresi maksimalisht 600mm dhe gjatesi minimalisht 650mm. Pjesa e montimit te behet me ane te dy vrimave me largesi 280mm. .Lavamanet duhet te permbushin kerkesat funksionale ,rezistenca e ngarkeses,pastrueshmeria,qendrueshmeria shkalla e rrjedhjes sipas normes SSH EN 14688 ose ekuivalente Duhet te paraqiten: **Kataloget/ skedat teknike te shoqeruara me Çertifikatë Konfirmiteti CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi .**

Boljer Ngrohesis e ujit duhet te jene te pershtatshem per te plotesuar e gjitha kerkesat per ujin e ngrohite te mundesojne instalimin e tyre kudo horizontal dhe vertikal me nje rryme 220-240 V AC .Shtresa e jashte te jete abs e forte dhe rezistenca e ngrohjes se ujit celik inoxi Klasa ERP:CI pajisur me valvul presioni deri ne 6 bar,tregues te nivelit te

temperatures,tregues I drites ndezje/fikje,regjistrim manual I temperatures. Duhet te paraqiten: **Kataloget/ skedat teknike te shoqeruara me Çertifikatë Konfirmiteti CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi.**

Argumentimi Ligjor dhe Teknik : Në bazë të nenit 4, nenit 36 si dhe nenit 79 pika 2 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe bazuar ne nenin 44 pika 1, e VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 .Ky kriter eshte vendosur qe AK te kete sigurine qe operatori ekonomik qe do te ofertoje te jete i pajisur me certifikatat e mesiperme, te lidhura me objektin e prokurimit, gje e cila krijon bindjen dhe sigurine te Autoriteti Kontraktor qe ky Operator Ekonomik i zoteron kapacitetet teknike per realizimin me sukses te kontrates

Në nenin 44 të Vendimit nr.285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave parashikohet se: “1. Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit
Kjo kerkese është kërkuar që ti sigurojë Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshem Teknik dhe ploteson specifikimet e kerkuara nga projektuesit për zbatimin në kohë dhe cilësi të kontratës për këtë objekt. Për të krijuar bindjen e autoritetit kontraktor për aftësitë teknike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur të operatorëve ekonomik fitues potencialë dhe realizimin me sukses të kontratave, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizim nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/ distributor autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë pajisjet dhe mallrat e nevojshme në këtë procedurë prokurimi. Duke qenë se materialet e kerkuara prodhohen në mënyrë industriale, certifikimi nga prodhuesi mbi parametrat e tyre është i domosdoshëm. Ne menyre qe Autoriteti Kontraktor te verifikoje qe specifikimet teknike te paisjeve te propozuara nga operatoret ekonomik plotësojnë parametrat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike te përcaktuara në dokumentat e tenderit , duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar si: çertifikatë/deklaratë konfirmiteti CE, certifikatat e cilesise ose raportet e testimit nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara ne Specifikimet teknike .

Duke marrë shkas nga tipologjia e objektit të prokurimit dhe nga punimet/shërbimet që parashikohen të realizohen në preventiv si dhe per shkak te interesit te larte qe ka objekti duhet të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve më të mira europiane. Prandaj e gjykojme të domosdoshme të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve më të mira europiane, që OE ka aftësi të mjaftueshme për të realizuar me sukses dhe cilësi kontratën,duke furnizuar brenda kohës së përcaktuar vetëm pajisje origjinale me garanci, si dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për të bërë krahasueshmërinë e materialeve të ofruara nga operatori me ato të kërkuara në dokumentat e tenderit.

Për të siguruar këtë gjë, por njëkohësisht dhe për të detyruar ofertuesit e mundshëm në zbatimin e këtyre standarteve ka parashikuar kërkesen e mësipërme vetëm për disa nga mallrat kryesorë me që do të përdoren në këtë objekt konkretisht OE duhet të japin dhe paraqesin ne menyre te detajuar karakteristikat teknike të mallrave të përfshirë në dokumentat e tenderit, karakteristika këto që duhet të përputhen me specifikimet teknike të kërkuara nga projektuesi.

Për këtë, ofertuesit duhet të deklarojnë produkte të pajisura me çertifikatë konformiteti CE/certifikate cilesie etj. Me anë të venies ne dispozicion ne fazen e ofertimit dokumentat si autorizim-marreveshje angazhimi, skeda teknike,certifikata cilesie, certifikata konformiteti,raporte testimi ofertuesi garanton Autoritetin Kontraktor se mallrat që do të furnizojë do të jenë prodhim sipas kerkesave te projektit. Plotesimi i kerkeses sipas pikes 9, garanton Autoritetin Kontraktor per cilesine dhe standartet e larta nderkombetare dhe te perditesuara sipas teknologjise se re dhe bashkekohore.

Gjithashtu ne përzgjedhjen e grup mallrave të mësipërme të cilat do të vendosen në objekt si edhe shërbejnë për ndërtimin e objektit, është marrë në konsideratë një test balancues dhe proporcional në përzgjedhjen e tyre. Kështu është vlerësuar se në përzgjedhjen e grup mallrave të mësipërme të cilat do të vendosen në objekt janë marrë në konsideratë 2 faktorë, volumni i tyre, duke marrë në konsideratë parashikimet e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” ku parashikohet se Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese. Sa më sipër, materialet e sipërcituara zënë një peshë specifike në punimet që do të kryhen në objekt, ndaj kërkesa lidhur me to është në proporcion me natyrën dhe volumnin e punimeve. Ky kriter i marrë në konsideratë lidhet ngushtësisht me faktin se shumica e produkteve të mësipërme kanë bazë kimike dhe kanë /mund të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në shëndetin e komunitetit etj. Akoma më tej vlerësojme se kemi të bëjmë me një objekt kulturor ku përpueshmëria e cilësisë së materialeve të vendosura në objekt nuk duhet të sjellë pasoja shëndetësore në shëndetin e qytetareve etj, duhet të përmbushë nivelin ekologjik të kërkuar dhe duhet të jetë në përputhje me Standardet e Njohura në Republikën e Shqipërisë.

Kërkesa për dorëzimin e formatit të autorizimit të prodhuesit dhe katalogëve për produktet e sipërcituara është një kërkesë në përputhje dhe proporcio me natyrën dhe volumnin e kontratës dhe se i shërben qëllimit të autoritetit kontraktor, nuk krijon pengesa të dukshme ose të fshehura për ofertuesit si edhe nuk diskriminon midis operatorëve ekonomikë vendas dhe të huaj, pasi standardet e kërkuara është Standardi Shqiptar i cili është i harmonizuar me Standardin European. Gjithashtu, në përputhje dhe proporcion me vlerën dhe natyrën e kontratës dhe peshës sepcifike të secilës prej mallrave që do të vendosen në objekt atëherë është parashikuar që për një pjesë prej tyre të dorëohen vetëm katalogjet ndërsa për mallrat dhe paisjet të cilat kanë një ndikim të veçantë në mjedis si edhe ndikim të veçantë në shëndetin qytetareve, krahas katalogjeve të prodhuesit është kërkuar edhe dorëzimi i raport testeve zyrtare të lëshuar nga laboratorë të akredituar në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Gjithashtu, kriteri i mësipërm nuk shfaq diskriminim mes operatorëve të cilët blejnë dhe ofertojnë për kryerjen e punimeve me produkte të gatshëm pasi dokumentacioni i kërkuar me siper disponohet nga cdo prodhues serioz vendas apo i huaj.

2.3.14 Operatori ekonomik duhet te kete në dispozicion apo mund t’I vihen në dispozicion mjetet e pajisjet teknike te nevojshme per ekzekutimin e kontrates, si me poshte (sipas formularit permbledhes te vetedeklarimit):

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes deri 5-10 Ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes mbi 20 Ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamioncine me kapacitet mbajtes 3.5 - 5 Ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Autovinc	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me zinxhir me kove 0.25m3	1 copë	Pronësi ose me qera
Fadrom me goma me kove para mbrapa	1 copë	Pronësi ose me qera
Minifadrom	1 copë	Pronësi ose me qera
Minieskavator	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	2 copë	Pronësi ose me qera

Autopompe Betoni	1 copë	Pronësi ose me qera
Betoniere kantieri	3 copë	Pronësi ose me qera
Vibrator betoni	3 copë	Pronësi ose me qera
Autobot uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Nivelues betoni helikopter	1 copë	Pronësi ose me qera
Matrapik	2 copë	Pronësi ose me qera
Elektroorgano	1 copë	Pronësi ose me qera
Elektrosaldatriçe	1 copë	Pronësi ose me qera
Gazogjen	1 copë	Pronësi ose me qera
Skeleri fasade	3000m2	Pronësi ose me qera
Makine per ngjitje tubash	1 copë	Pronësi ose me qera
Aparat elektrofuziv	1 copë	Pronësi ose me qera
Gjeneratore	1 copë	Pronësi ose me qera
Pompë suvatimi	2 copë	Pronësi ose me qera
Pllake vibruese	1 copë	Pronësi ose me qera
Pajisje per hekurkthyes (tranxhe,elektrobango)	1 copë	Pronësi ose me qera
Kapese per lidhje hekuri	2 copë	Pronësi ose me qera

Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 90 copë
- Rripa lidhës sigurimi për punime në lartësi minimumi 10 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 5copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 5 copë
- Uniforma / Jelek pune 90 cope
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 25 copë

a) Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme).

b) Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: kontrata përkatëse e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme, dokumenti qe verteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, çertifikatë për transport mallrash.

c) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira te tij.

d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

e) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas Deklaratës së shoqërisë ofertuese.

f) Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën e verifikimit të saktësisë së informacionit. Mos dorëzimi i informacionit të saktë apo të rremë do të konsiderohet kusht për skualifikim.

Shënim: Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin".

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK

Argumentimi Ligjor dhe Teknik : Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronësi / qira / kontrate furnizimi janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe asetëve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave. Gjithashtu për përcaktimin e numrit të mjetëve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislationit të fushës bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre" (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018).

Kërkesa për pajisjen me makineritë e mesiperme është e nevojshme për arsyet si mëposhte:

NR	KODI	EMËRTIMI I PUNIMEVE	NJËSIA	SASIA	Mjete dhe vegla
6	3.197/2	Prishje shtresash ekzistuese, t=10cm.	m2	312.0	fadrome
7	2.28a	Germim dheu themele e plinta me b-2m, ekskavator me zinxhir 0.25m3,shkarkimi ne auto	m3	3320.0	eskavator me kove 0.25
8	2.37/5a	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km	m3	7450.0	kamion vetshkarkues mbi 20t
18	2.273/4	Shtrese me pllaka mermeri t=2cm	m2	233.0	autovinc
19	2.278	Shtrese polistireni termoizoluese dhe dhenie pjeresie ne tarace	m3	130.0	betoniere 250 lit, vinc kulle
20	2.267/1	Shtrese me pllaka porcelanat	m2	910.0	autovinc
22	2.262/4b	Pllake themeli, trare e bazamente b/a C 25/30	m3	312.0	autobetoniere, autopompe, vibrator.skele
23	2.119/1a	Trare e arkitrare b/a C20/25 h ~ 4m	m3	397.0	autobetoniere, autopompe, vibrator.skele
24	2.117/1b	Kollona b/a monolite C 25/30 h ~ 4m	m3	427.0	autobetoniere, autopompe, vibrator.skele
25	2.125/1a	Soleta b/a me polisterol dhe rrjete teli C 20/25 t=30cm, h~6m	m2	4364.0	autobetoniere, autopompe, vibrator.skele
26	2,129	Mure b/a t = 11-20cm h ~ 4m C 16/20	m3	38.0	vibrator.skele
27	2,121	Breza b/a monolit C 16/20	m3	28.0	vibrator.skele
28	2.207	Mur betoni C 16/20	m3	25.0	vibrator.skele
29	2.202	Themel e xokol butobetoni C16/20	m3	15.0	vibrator
30	2.692	Kapuç betoni monolit C 12/15 mbi mure	m3	2.0	autovinc, vibrator.skele
31	2.166/1a	F.V. Hekur betoni periodik Ø > 12 mm	ton	201.0	tranxhe, kapese hekuri
32	2.166	F.V. Hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm	ton	56.0	tranxhe, kapese hekuri
45	2.310/1	Suva brenda mur tulle ~ 4m, me pompe, ll perzier M 25	m2	6825.0	pompe suvatimi, vinc kulle
46	2.358/c	Veshje muri me polisterol te thjeshte t=5cm rrjete+suva.	m2	3000.0	elektroorgano, trapano,skele
49	2.86.	Mur me tulla me 6 vrima, t=12cm h~3m, ll perz M 15	m3	644.0	auto vinc, skele
50	2.70/2	Mur me tulla te lehtesuara deri - 3 m, LL.P. M-25	m3	8.0	auto vinc, skele
51	4.3	Konstruksione metalike te thjeshta	ton	6.0	saldatrice,gazogjen,trapano,vinc eskavator,autovinc
52	2.197	Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 k katrama	m2	1303.0	elektroorgano
53					
54					

60					
61	2.415	F.V. Porte metalike dekorative rreshqitese	m2	6.0	auto vinc
67	AnAn1	F.V. Pilota b/a per mbrojtjen e themelit te ndertesave	ml	324.0	Autovinc 5t, sonde
69					
14	2.215	F.V. Bolier 80 liter, uje te ngrohte	copë	4	trapano
15	2.217	F.V. Bolier 12 liter, uje te ngrohte sanitar	copë	7	trapano
19	2.598	F.V. Pusete shkarkimi 50x50, h=150, me kapak me zgare	copë	10	vibrator,betoniere
20	2.336	Pusete shkarkimi 80 x 80, h = 100 cm	copë	4	vibrator,betoniere
1	An (P)	Hapje vrime ne mur tulle per kalim tubi 20, 25, 32mm	copë	120	Matrapik
2	An (P)	Hapje vend per montim PT-5, PT-7, PT-8, PT-9	copë	150	Matrapik
3	An (P)	Hapje dhe mbyllje kanali per tuba D - 20, 25, 32mm	ml	600	Matrapik
7	2.690	Bazamente Beton C-16/20 per bazamente, shtylla e puseta	m3	10	vibrator, betoniere
1	An (P)	F.V. Zgara metalike zinkato ndarje transformatori ne	kg	135	saldatrice,gazogjen,trapano,vinc eskavator,autovinc

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike, termat e references, raporti teknik, preventivi me zerat e punimeve jane pjese DST